



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 700/14 Prot.

Tiranë, më 6.5. 2021

URDHËR

Nr. 84, datë 6.5. 2021

PËR

**MIRATIMIN E “STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT PËR
PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË
KOMUNIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkonjës c, pika 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkonjës d, të pikës 5, të kreut III, të Vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”,

U R D H Ë R O J:


1. Miratimin e “Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Evis KUSHI





STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT PËR PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT

Maj, 2021

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	2
Hyrje	3
Kujt i shërbejnë standardet?	4
Struktura e standardit	5
PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT PËR PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK)	6
Përshkrim përmbledhës	6
STANDARDI 1: Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore në lidhje me TIK-un	7
STANDARDI 2: Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësve	8
STANDARDI 3: TIK dhe metodologjitë e mësimdhënies-nxënies	9
STANDARDI 4: Zbatimi i aftësive digjitale	10
STANDARDI 5: Organizimi dhe menaxhimi i mjedisit për përdorimin e aftësive digjitale 	11
STANDARDI 6: Zhvillimi profesional i mësuesit për përdorimin e aftësive digjitale	12

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) u hartuan në kuadër të bashkëpunimit të ASCAP-it me UNICEF.

© Copyright 2021

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP dhe UNICEF, Tiranë, Shqipëri

PJESA E PARË

HYRJE

Interesi gjithnjë e në rritje për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri për të gjithë botën e sotme.

Zhvillimi i shpejtë i TIK-ut po shoqërohet me ndryshime të shumta dhe të shpejta në shoqëri. Këtyre ndryshimeve arsimit duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta dhe me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente e të qëndrueshme të nxënësit, të cilët garantojnë krijimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë.

Jetojmë në epokën digjitale ku nga njëra anë kemi nxënësit, të cilët janë përdorues shumë të mirë të teknologjisë, ndërsa në anën tjetër ndeshemi me mësues, të cilët akoma nuk kanë aftësitë e duhura për t'u përgjigjur sfidave të kohës për një mësimdhënie dhe nxënie moderne me bazë të gjerë integrimin dhe përdorimin e TIK-ut.

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Shkollat dhe klasat, si ato reale ashtu edhe ato virtuale, duhet të kenë mësues të cilët duhet të dinë që gjatë procesit të mësimdhënies të ndërlidhin tri komponentë: përmbajtjen e lëndës, pedagogjinë dhe teknologjinë.

Një mësuesi për të qenë i aftë në punën e tij nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht të nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore, ku TIK ka vlera të domosdoshme dhe të patjetërsueshme për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënie-nxënies. TIK nuk ndikon vetëm në një mësimdhënie të suksesshme, por dhe në mundësitë që u krijon mësuesve për të mësuar dhe për të bashkëpunuar me njëri - tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve, përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta pedagogjike.

Në të gjitha vendet evropiane e më gjerë, TIK është bërë pjesë e domosdoshme e kurrikulave, si një metodologji e re për integrimin e tij në mësimdhënie. Arsimit sot kërkon mësues të pajisur me të gjitha aftësitë e nevojshme për të mësuar nxënësit, të cilët duhet të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat e zhvillimeve të reja të botës moderne digjitale. Për këtë arsye Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe

Shoqata Ndërkombëtare për Teknologjinë e Edukimit (ISTE), kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit. Këto paketa standardesh u kanë siguruar shteteve, rajoneve, shkollave dhe institucioneve të edukimit themele mbi të cilat ngrihet filozofia dhe hartohen plane për integrimin e teknologjisë në kurrikul.

Në këto kushte dhe në Shqipëri shtrohet si domosdoshmëri hartimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie – mësimnxënie, për t'u siguruar që të gjithë mësuesit të jenë të mirëpërgatitur, për të përdorur TIK-un në procesin mësimor me qëllim pajisjen e nxënësve me aftësitë e shekullit XXI.

Vendosja e standardeve do të ndërgjegjësojë çdo mësues që të integrohet me qasjet e reja të epokës digjitale, të cilat kërkojnë që ata të jenë të aftë të zbatojnë metodologjinë e integritit të TIK-ut në mësimdhënie. Integrimi me sukses i TIK-ut në klasë do të varet nga aftësia e mësuesve për të strukturuar mjedisin e të nxënësve, për të shkruar teknologjinë e re me metodologjinë, për të zhvilluar klasa aktive, për të nxitur ndërveprimin, të nxënësve bashkëpunues dhe punën në grup.

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie kanë për qëllim të sigurojnë një qasje të standardizuar për të gjithë mësuesit, në lidhje me përdorimin e TIK-ut në shkollë dhe në procesin mësimor. Këto standarde përcaktojnë treguesit për zbatimin e TIK-ut në procesin mësimor, si dhe synojnë të përgatisin mësuesit për t'u bërë përdorues të teknologjive të ndryshme të komunikimit dhe të informimit.

KUJT I SHËRBEJNË STANDARDET?

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut përshkruajnë atë që pritet të njohë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi në lidhje me integrimin dhe përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie-nxënies.

- a) Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut i shërbejnë në radhë të parë **vetë mësuesit**. Mësuesi mbështetet në to për të vlerësuar performancën e tij, duke dalluar anët e tij të forta dhe nevojat, si dhe për të kuptuar më mirë përparimin e tij profesional. Standardet përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, për të cilat mësuesi tregon angazhimin për kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Përbushja e standardeve mbështet mësuesin për progresin e tij në karrierë dhe për kualifikimin e tij.

- b) Standardet profesionale të mësuesit i shërbejnë ***drejtuesit të shkollës*** në mënyrë që të përmbledhë nevojat profesionale të mësuesve dhe mbi këtë bazë të hartojë dhe të zbatojë planin e zhvillimit profesional të tyre.
- c) Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut i shërbejnë ***këshillit të mësuesve dhe ekipeve lëndore***, të cilët mund t'i përdorin këto standarde për përmirësimin e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësuesve.
- d) Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut i shërbejnë ***Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)*** për formulimin e politikave mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit dhe përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie/nxënies.
- e) ***Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)*** mbi bazën e këtyre standardeve identifikon nevojat e mësuesve për zhvillim profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar. Gjithashtu, ky institucion ndihmon mësuesit dhe shkollat në vlerësimin e performancës së tyre.
- f) ***Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore Arsimore (ZVA)*** duke u mbështetur në standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.
- g) ***Fakultetet e edukimit*** mbështeten në këto standarde për të hartuar në koherencë standardet e formimit fillestar të mësuesve, si dhe për të mundësuar përmes kurrikulës përkatëse përgatitjen e mësuesve në lidhje me to.
- h) ***Organizatat dhe institucionet*** që punojnë në fushën e arsimit, mund ta përdorin dokumentin e standardeve në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të përzgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

STRUKTURA E STANDARDIT

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut janë pohime, të cilat harmonizojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat profesionale të mësuesit në lidhje me përdorimin e TIK-ut si pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Struktura e standardit përmban titullin dhe përshkrimin e përmbledhur të standardit. Çdo standard zërthehet në disa tregues të detajuar dhe të matshëm, të cilët u referohen në mënyrë të

harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi, klasifikojnë aftësitë që duhet të demonstrojë ai dhe reflektojnë qëndrimet apo vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënie-nxënies.



PJESA E DYTË

STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT PËR PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT (TIK)

Përshkrim përmbledhës

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut janë hartuar duke u bazuar në dokumente rekomanduese të hartuara nga Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO). Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përmbushur dhe në ç’shkallë është përmbushur një standard i caktuar. Standardet nuk mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë të ndërlidhura dhe duhen menduar si një e tërë.

Standardet nuk e kufizojnë origjinalitetin dhe krijimtarinë e mësuesit, madje e nxisin atë. Ato unifikojnë pretendimet profesionale dhe etike në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesit për përdorimin e TIK në mësimdhënie-nxënie.

Standardi “**Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore në lidhje me TIK-un**” i referohet njohurive në lidhje me politikat arsimore dhe me prioritetet kombëtare dhe institucionale mbi rolin e TIK-ut dhe përdorimin e tij në procesin e mësimdhënie - nxënies.

Standardi “**Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësve**” përfshin treguesit që lidhen me integrimin e përdorimit të TIK-ut në përmbajtjen e

lëndës në funksion të zhvillimit të kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore, si dhe për kryerjen e praktikave të vlerësimit të nxënësve në lidhje me to.

Standardi **“TIK dhe metodologjitë e mësimdhënie - nxënies”** vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë që duhet të zotërojë mësuesi për përdorimin e TIK-ut në mbështetje të metodave efektive të mësimdhënies me në qendër nxënësin, në mënyrë të veçantë të mësimdhënies së bazuar në projekte dhe në zgjidhjen e problemeve që kërkojnë hulumtim dhe bashkëpunim.

Standardi **“Zbatimi i aftësive digjitale”** përfshin njohuritë dhe aftësitë e përdorimit të TIK-ut dhe mjeteve digjitale, të tilla si kompjuter, pajisje mobile, programe kompjuterike, postë elektronike, platforma online, rrjete sociale etj., për qëllime mësimore. Mësuesi siguron akses dhe përdorim të sigurt të këtyre mjeteve digjitale për të gjithë nxënësit. Ai identifikon dhe njeh funksionin e mjeteve digjitale me qëllim përdorimin e tyre për të përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënies.

Standardi **“Organizimi dhe menaxhimi i mjedisit për përdorimin e aftësive digjitale”** i kushtohet njohurive dhe aftësive të përdorimit të TIK-ut për krijimin dhe ndërtimin e mjediseve virtuale të të nxënit duke mbështetur bashkëpunimin, gjithëpërfshirjen, të mësuarin në klasë dhe jashtë saj. Mësuesi krijon mjedise të hapura dhe fleksibile të të nxënit, ku TIK përdoret për të mbështetur një larmi bashkëveprimesh mes nxënësish dhe ndarje eksperiencash mes kolegëve.

Standardi **“Zhvillimi profesional i mësuesit për përdorimin e aftësive digjitale”** vendos në fokus njohuritë dhe aftësitë për të përdorur TIK-un në mësimdhënie, kërkime, bashkëpunime e shkëmbime përvojash ndërmjet mësuesve, në mbështetje të zhvillimit profesional. Mësuesi zhvillon njohuritë digjitale dhe përdor TIK-un për t’u angazhuar në rrjetet profesionale të mësuesve dhe për të aksesuar burime kurrikulare.

STANDARDI 1: Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore në lidhje me TIK-un

1.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuri në lidhje me politikat arsimore, prioritetet kombëtare dhe institucionale mbi rolin e TIK-ut dhe përdorimin e tij në procesin e mësimdhënies/nxënies. Ai zbaton parimet, orientimet dhe prioritetet e politikave arsimore në lidhje me përdorimin e TIK-ut duke i përshtatur ato në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, sugjeron rishikime dhe përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e tyre.

1.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1. njeh politikat arsimore në lidhje me rolin dhe me përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie- nxënies;
- 1.2.2. identifikon orientimet dhe përparësitë e politikave kombëtare dhe institucionale në lidhje me përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie-nxënie;
- 1.2.3. zbërthen, përshtat dhe zbaton orientimet dhe përparësitë e politikave arsimore në nivel shkolle dhe klase;
- 1.2.4. analizon çështjet që lindin në procesin e zbatimit të politikave në nivel shkolle dhe klase;
- 1.2.5. sugjeron përmirësime të çështjeve që lidhen me zbatimin e politikave arsimore në lidhje me TIK-un.

STANDARDI 2: Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësve

2.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi për integrimin e TIK-ut në përmbajtjen e lëndës në funksion të zhvillimit të kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore, si dhe për vlerësimin e nxënësve. Mësuesi vendos nxënësin në qendër duke siguruar gjithëpërfshirjen e bashkëpunimin, si dhe kujdeset që nxënësit gjatë përdorimit të TIK-ut të demonstrojnë zhvillimin e kompetencave kyç dhe lëndore.

2.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 2.2.1 identifikon dhe njeh programe dhe aplikacione kompjuterike të përshtatshme për zhvillimin e kurrikulës;
- 2.2.2 demonstroi mënyrën e përdorimit të programeve dhe të aplikacioneve kompjuterike në funksion të përmbushjes së rezultateve të nxënësve në lëndën e tij;
- 2.2.3 përdor TIK-un për të mbështetur strategjitë e vlerësimit të nxënësve, përfshirë projektin kurrikular, portofolin e nxënësve etj.;
- 2.2.4 udhëzon nxënësit për përdorimin e TIK-ut për të kërkuar, menaxhuar, analizuar, vlerësuar dhe përdorur informacionin;
- 2.2.5 udhëzon nxënësit në përdorimin e TIK-ut për realizimin e detyrave/punimeve që

mbështesin arsyetimin, planifikimin, zgjidhjen e situatave problemore, reflektimin dhe ndërtimin e njohurive;

2.2.6 udhëzon nxënësit në përdorimin e TIK-ut në funksion të zhvillimit të aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit;

2.2.7 ndihmon nxënësit të zhvillojnë vlerësime online për të provuar të kuptuarit dhe zbatimin e njohurive dhe të aftësive në kontekstin e lëndës.

STANDARDI 3: TIK dhe metodologjitë e mësimdhënie - nxënies

3.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron dhe zhvillon njohuri dhe aftësi të përdorimit të TIK-ut në mbështetje të metodave efektive të mësimdhënies me në qendër nxënësin, në mënyrë të veçantë të të nxënit të bazuar në projekte dhe në zgjidhjen e problemeve që kërkojnë hulumtim dhe bashkëpunim. Mësuesi bën zgjedhje të përshtatshme të programeve dhe të aplikacioneve kompjuterike për të mbështetur metodologjitë specifike të mësimdhënies dhe të të nxënit. Mësuesi di se *ku*, *kur* dhe *si* të përdorë TIK-un për veprimtaritë dhe prezantimet në klasë.

3.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

3.2.1. identifikon zgjedhje të përshtatshme për përdorimin e TIK-ut që mbështesin përmbushjen e rezultateve të të nxënit nga nxënësit;

3.2.2. identifikon dhe vlerëson e-burimet që mbështesin të nxënit e bazuar në projekte;

3.2.3. përdor software prezantimi dhe burime digjitale për të mbështetur udhëzimet që u jep nxënësve;

3.2.4. përdor TIK-un për të mbështetur nxënësit në përvetësimin e njohurive të lëndës;

3.2.5. ndihmon nxënësit të identifikojnë burime të medias digjitale që mbështesin mësimin dhe ndërveprimin e tyre me audiencat e tjera;

3.2.6. planifikon dhe zhvillon veprimtari që realizohen përmes përdorimit të TIK-ut dhe që sigurojnë përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive, vlerave dhe qëndrimeve nga nxënësit;

3.2.7. harton materiale online që mbështesin të kuptuarit e koncepteve nga nxënësit dhe zbatimin e tyre në jetën reale;

- 3.2.8. punon në grupe për të zhvilluar dhe për të vlerësuar materialet online duke i mbështetur nxënësit në përdorimin e tyre, si dhe në veprimtaritë e të nxënit;
- 3.2.9. ndihmon nxënësit të planifikojnë dhe të zhvillojnë nëpërmjet TIK-ut, projekte që i angazhojnë ata në hulumtime bashkëpunuese për zgjidhjen e problemeve, kërkimin shkencor dhe krijimet artistike;

STANDARDI 4: Zbatimi i aftësive digjitale

4.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi rreth mjeteve digjitale, të tilla si kompjuter, pajisje mobile, programe kompjuterike, aplikacione, postë elektronike, platforma online, rrjete sociale etj., për qëllime mësimore. Mësuesi siguron akses dhe përdorim të sigurt të këtyre mjeteve digjitale për të gjithë nxënësit. Ai përzgjedh mjete të ndryshme digjitale për të krijuar një mjedis të nxëni, si dhe për të zhvilluar te nxënësit aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit. Mësuesi përdor mjetet digjitale për të mbështetur të mësuarit gjithëpërfshirës. Ai përdor internetin, platformat, rrjetet sociale dhe burimet elektronike për qëllime mësimore, komunikimi dhe menaxhimi brenda një kornize të përdorimit të sigurt.

4.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 4.2.1. kupton dhe demonstroi përdorimin e mjeteve digjitale për qëllime mësimore;
- 4.2.2. përdor programet e paketës Microsoft Office;
- 4.2.3. krijon dokumente të thjeshta;
- 4.2.4. krijon prezantime të thjeshta;
- 4.2.5. krijon grafikë të thjeshtë;
- 4.2.6. navigon në internet;
- 4.2.7. orienton nxënësit për të kërkuar informacion në faqet e dhura në internet;
- 4.2.8. kupton parimet themelore të sigurisë kibernetike, edukimit mediatic dhe informativ;
- 4.2.9. realizon lidhjen e kompjuterit me internetin;
- 4.2.10. përdor motorë kërkimi për të aksesuar burime të ndryshme kurrikulare;
- 4.2.11. krijon një llogari e-maili dhe e përdor atë për aktivitete të përditshme mësimore;
- 4.2.12. përdor aplikacione software për të mbajtur shënime dhe të dhëna për nxënësit;

- 4.2.13. përdor teknologjitë e komunikimit, përfshirë këtu dhe teknologjinë mobile, për të integruar aftësitë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- 4.2.14. përdor rrjetet sociale për të komunikuar me nxënësit dhe me prindërit;
- 4.2.15. merr masa për zgjidhjen e problemit kur teknologjia dështon, për të siguruar vazhdimin e mësimin;
- 4.2.16. përdor paketa software që janë të përshtatshme për lëndën, për të zhvilluar te nxënësit aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit;
- 4.2.17. vlerëson saktësinë dhe dobinë e burimeve të internetit që përdor në mbështetje të lëndës;
- 4.2.18. përdor programe kompjuterike për të hartuar materiale kurrikulare;
- 4.2.19. përdor mjete digjitale të komunikimit për të mbështetur shkëmbimin e njohurive dhe bashkëpunimin ndërmjet nxënësve brenda dhe jashtë klasës;
- 4.2.20. vlerëson mjetet digjitale dhe burimet për të mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsim;
- 4.2.21. përdor mjete digjitale për të vlerësuar njohuritë, aftësitë dhe kontributet e nxënësve;
- 4.2.22. inkurajon nxënësit të përdorin mjetet digjitale për qëllime mësimore;
- 4.2.23. krijon dhe përdor llogari në rrjete sociale që përfshin nxënës dhe mësues, me qëllim bashkëpunimi, shkëmbim përvojash dhe informacioni;
- 4.2.24. instalon dhe përdor mjete të ndryshme digjitale të tilla si: kompjuter, printer, projektor, micro-bit, etj., gjatë procesit mësimor;
- 4.2.25. përdor në mënyrë efektive komponentët e komunikimit online (zoom, skype, google classroom, microsoft teams etj.).

STANDARDI 5: Organizimi dhe menaxhimi i mjedisit për përdorimin e aftësive digjitale

5.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron dhe zhvillon njohuri e aftësi të përdorimit të TIK-ut për krijimin dhe ndërtimin e mjediseve virtuale të të nxënit duke mbështetur bashkëpunimin dhe gjithëpërfshirjen në klasë dhe jashtë saj. Mësuesi organizon mjedisin fizik me qëllim që TIK të mbështesë në mënyrë gjithëpërfshirëse metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Ai krijon mjedise të hapura dhe fleksibile të të nxënit, ku TIK përdoret për të mbështetur një larmi bashkëveprimesh mes

nxënësve dhe ndarje eksperiencash mes kolegëve. Mësuesi siguron përdorimin etik të TIK-ut për veprimtari të ndryshme mësimore me të gjithë klasën, me grupe të vogla nxënësish apo me individë duke siguruar akses të barabartë për të gjithë nxënësit.

5.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 5.2.1. organizon mjedisin fizik me qëllim që TIK të mbështesë në mënyrë gjithëpërfshirëse metodologji të ndryshme të mësimdhënie-nxënies;
- 5.2.2. identifikon teknologjitë e duhura, përfshirë pajisjet mobile, për të mbështetur mësimdhënie-nxënien;
- 5.2.3. përdor platformat online gjatë procesit mësimor;
- 5.2.4. krijon strategji të integritit të TIK-ut në lëndën e tij;
- 5.2.5. përdor burimet digjitale për të mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta;
- 5.2.6. përdor burimet digjitale për të mbështetur aktivitetet mësimore me në qendër nxënësin;
- 5.2.7. përdor TIK-un për të menaxhuar dhe për të drejtuar projekte individuale dhe në grup të nxënësve;
- 5.2.8. përdor TIK-un në mjedisin mësimor për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit;
- 5.2.9. krijon mjedise virtuale të të nxënit duke mbështetur bashkëpunimin dhe gjithëpërfshirjen në klasë dhe jashtë saj;
- 5.2.10. përdor TIK-un për të mbështetur një larmi bashkëveprimesh mes nxënësve;
- 5.2.11. përdor mjetet digjitale të komunikimit me qëllim që shkolla të shpërndajë informacione në komunitetin e gjerë shkollor;
- 5.2.12. planifikon përdorimin e mjeteve digjitale për të mbështetur organizimin dhe administrimin e klasës/shkollës.

STANDARDI 6: Zhvillimi profesional i mësuesit për përdorimin e aftësive digjitale

6.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron dhe zhvillon njohuri dhe aftësi për të përdorur TIK-un në mësimdhënie, bashkëpunim e shkëmbim përvojash ndërmjet mësuesve, në mbështetje të zhvillimit profesional. Mësuesi zhvillon njohuritë digjitale dhe përdor TIK-un për t'u angazhuar në rrjetet profesionale të mësuesve dhe për të aksesuar burime kurrikulare. Ai përdor teknologjinë për të modeluar dhe

për të ndarë praktikat më të mira në shkollë apo në rrjetin profesional.

6.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1. identifikon faqet zyrtare (website) arsimore dhe portalet mësimore;
- 6.2.2. përdor TIK-un për të aksesuar burime lëndore dhe për të zbuluar strategji të reja mësimore;
- 6.2.3. identifikon dhe menaxhon çështjet e sjelljes dhe sigurisë në internet;
- 6.2.4. respekton parimet e qytetarisë digjitale;
- 6.2.5. përdor TIK-un për të hyrë në rrjete profesionale apo platforma të mësuesve për të ndarë burime arsimore që mbështesin qëllimet e zhvillimit të tij profesional;
- 6.2.6. përdor TIK-un për të rritur produktivitetin si mësimdhënës;
- 6.2.7. përdor TIK-un për të qenë bashkëveprues në komunitetet edukative online dhe siguron akses në revistat e ndryshme edukative;
- 6.2.8. përdor TIK-un për të ndjekur tutoriale online ose programe pedagogjike online për zhvillimin e tij profesional;
- 6.2.9. rekomandon faqe të dobishme dhe të besueshme të kolegët dhe nxënësit;
- 6.2.10. ndan dhe diskuton praktikat më të mira në mësimdhënie përmes komuniteteve profesionale;
- 6.2.11. merr pjesë në forumet e mësuesve dhe diskutimet online;
- 6.2.12. bashkëpunon me kolegët ndan dhe shkëmben plane mësimore, fletë pune, modele dhe materiale mësimore nëpërmjet websiteve;
- 6.2.13. përshtatet ndaj ndryshimeve kurrikulare për t'i zbatuar ato në klasë në një kohë sa më të shkurtër;
- 6.2.14. zhvillon dhe zbaton një plan individual për rritjen e tij profesionale në lidhje me përdorimin e aplikacioneve teknologjike;
- 6.2.15. modelon procesin e të nxënësve përmes zhvillimit të tij të vazhdueshëm profesional - individualisht dhe në bashkëpunim.